



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.51

9 maj

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.90, datë 30.4.2007	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim ministri.....	1343
Vendim i Kuvendit nr.91, datë 30.4.2007	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim ministri.....	1343
Vendim i Kuvendit nr.92, datë 30.4.2007	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim ministri	1344
Vendim i Kuvendit nr.93, datë 30.4.2007	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim ministri	1344
Vendim i Kuvendit nr.94, datë 30.4.2007	Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)	1345
Vendim i Kuvendit nr.95, datë 30.4.2007	Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE)	1348
Vendim i Kuvendit nr.96, datë 30.4.2007	Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës	1351
Vendim i Kuvendit nr.97, datë 30.4.2007	Për miratimin e strukturës dhe organikës së Entit Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT).....	1354
Vendim i Kuvendit nr.98, datë 30.4.2007	Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	1358
Rezolutë e Kuvendit	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Bankës së Shqipërisë	1362

datë 3.5.2007

Dekret nr.5273 Për lirim ambasadori 1364
datë 27.4.2007

Dekret nr.5274 Për emërim ambasadori 1364
datë 27.4.2007

Dekret nr.5285 Për dhënie të shtetësisë shqiptare 1365
datë 2.5.2007

Vendim i KM Për një ndryshim në vendimin nr.185, datë 29.3.2006 të Këshillit të
nr.212, datë 18.4.2007 Ministrave “Për lejin e ndërmarrjes “MEICO” të Ministrisë së
Mbrojtjes, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, për
riparimin e helikopterëve BO 105 M VBH, të dhuruar nga Ministria e
Mbrojtjes e Republikës Federale të Gjermanisë dhe për sigurimin e
pjesëve të këmbimit për këta helikopterë” 1365

Vendim i KM Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.230, datë 4.4.1998 të
nr.213, datë 18.4.2007 Këshillit të Ministrave “Për privatizimin e pjesëve të kapitalit të
zotëruar nga shteti, në shoqëritë me kapital të përbashkët”, të
ndryshuar 1367

Vendim i KM Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.704, datë 11.10.2006 të
nr.215, datë 18.4.2007 Këshillit të Ministrave “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore,
që privatizohet, si dhe për procedurën e shitjes” 1368

Vendim i KM Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të
nr.216, datë 18.4.2007 licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës 1369

Vendim i KM Për lejin e kalimit transit të disa trupave ushtarake dhe të
nr.229, datë 25.4.2007 materialeve të ushtrisë turke, përmes territorit të Republikës së
Shqipërisë..... 1373

Vendim i KM Për lejin e kalimit transit të disa trupave ushtarake italiane, përmes
nr.231, datë 25.4.2007 territorit të Republikës së Shqipërisë..... 1374

Vendim i KM Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të
nr.233, datë 25.4.2007 paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i rrugës nga
kthesa e repartit ushtarak deri tek impianti i Bovillës..... 1374

VENDIM
Nr.90, datë 30.4.2007

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM
MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5275, datë 30.4.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5275, datë 30.4.2007 për shkarkimin e zotit Besnik Mustafaj nga detyra e Ministrit të Punëve të Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.91, datë 30.4.2007

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR SHKARKIM
MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5276, datë 30.4.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5276, datë 30.4.2007 për shkarkimin e zotit Lulzim Basha nga detyra e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.92, datë 30.4.2007

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM
MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5277, datë 30.4.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5277, datë 30.4.2007 për emërimin e zotit Lulzim Basha në detyrën e Ministrit të Punëve të Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM

Nr.93, datë 30.4.2007

**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR EMËRIM
MINISTRI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5278, datë 30.4.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5278, datë 30.4.2007 për emërimin e zotit Sokol Olldashi në detyrën e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM

Nr.94, datë 30.4.2007

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË ENTIT RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE
TË NDOTURA (ERRU)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 10 pika 1 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU),

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Struktura e ERRU-së është sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.

II. Organika e ERRU-së është sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur.

III. Numri i punonjësve të ERRU-së është 21.


IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Jozefina Topalli (Çoba)

**STRUKTURA
E ENTIT RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË
UJËRAVE
TË NDOTURA (ERRU)**

Lidhja nr.1



**ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
(ERRU)**

KOMISIONI I ERRU-SË		
KRYETARI		1
ANËTARË KOMISIONI		4
Sekretarja e Komisionit dhe Kryetarit		1
DREJTORIA TEKNIKO-EKONOMIKE		8
Drejtor drejtorie		1
Sektori Teknik dhe IT		
Përgjegjës sektori		1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të ujësjellësve dhe ITUP	1	1
Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUZ dhe ITUZ		1
Specialist i licencave dhe IT		1
Sektori Ekonomik dhe Monitorues		
Përgjegjës sektori		1
Specialist i vlerësimit të kostos dhe tarifave		1
Specialist i monitorimit dhe verifikimit të treguesve të punës		1
Sektori Juridik dhe i Marrëdhënieve me Publikun		
Përgjegjës sektori		1
Specialist		1
Sektori i Administratës, Financës dhe Burimeve Njerëzore		
Përgjegjës sektori		1
Specialist finance		1
Punonjës mbështetës		
Përgjegjës Arkiv-Protokoll	1	
Shoferi i Kryetarit	1	
Shoferi i Komisionit	1	
		21

VENDIM
Nr.95, datë 30.4.2007

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË ENTIT RREGULLATOR TË
SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (ERE)**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 10 pika 1 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE),


KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Struktura e ERE-s është sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
- II. Organika e ERE-s është sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur.
- III. Numri i punonjësve është 28.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Struktura e ERE-s



**ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

BORDI I KOMISIONERËVE

KRYETARI I ERE-S	1
ANËTARË BORDI	4
Këshilltar i Bordit	1
Sekretar i Bordit	1

DREJTORIA E LICENCIMIT DHE MONITORIMIT TË TREGUT

Drejtor drejtorie	1
Sektori i Licencimit	
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1
Sektori i Monitorimit të Tregut	
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1

DREJTORIA E ÇMIMEVE DHE TARIFAVE

Drejtor drejtorie	1
Sektori i Strukturës së Tarifave	
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1
Sektori i Analizës së Çmimeve	
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1

DREJTORIA JURIDIKE DHE E MBROJTJES SË KONSUMATORIT

Drejtor drejtorie	1
Sektori i Legjislacionit	
Përgjegjës sektori	1
Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe i Marrëdhënieve Publike	
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, ADMINISTRATË-FINANCËS DHE E
MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Drejtor drejtorie	1
Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë Përgjegjës sektori	1
Specialist finance	1
Personel shërbimi	4

28

**VENDIM
Nr.96, datë 30.4.2007**

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË AUTORITETIT TË
KONKURRENCËS**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 10 pika 1 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, me propozimin e Autoritetit të Konkurrencës,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**


VENDOSI:

- I. Struktura e Autoritetit të Konkurrencës është sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
- II. Organika e Autoritetit të Konkurrencës është sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur.
- III. Numri i punonjësve është 35.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**

LIDHJA NR.1

STRUKTURA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS



ORGANIKA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

POZICIONI	NUMRI
I. KRYETARI	1
II. KOMISIONER	4
III. KABINETI	3
1. Drejtor kabineti	1
2. Këshilltar	1
3. Specialiste (asistente)	1
IV. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM	1
V. <i>Saktori i Analizës dhe Studimeve</i>	3
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1
Specialist (IT)	1
VI. DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË TREGUT	10
Drejtor	1
<i>Saktori Pozitës Dominuese</i>	
Përgjegjës sektori	1
Specialistë	2
<i>Saktori Anti-Kartel</i>	
Përgjegjës sektori	1
Specialistë	2
<i>Saktori i Përqendrimeve</i>	
Përgjegjës sektori	1
Specialistë	2
VII. DREJTORIA JURIDIKE DHE E INTEGRIMIT	6
Drejtor	1
<i>Saktori i Integrimit European</i>	2
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1
Saktori i Hetimit dhe Çështjeve Juridike	3
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1
Specialist	1
VIII. DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE DHE DOKUMENTACIONIT	8
Drejtor	1
Saktori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Dokumentacionit	5
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1

Shofer	2
Pastruese	1
Sektori i Shërbimeve të Financës	2
Përgjegjës sektori	1
Specialist (arkëtar-magazinionier)	1
GJITHSEJ	35

VENDIM
Nr.97, datë 30.4.2007

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË ENTIT RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE (ERT)**


Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 10 pika 1 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të instituteve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, me propozimin e Entit Rregullator të Telekomunikacioneve (ERT)

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Struktura e ERT-së është sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
- II. Organika e ERT-së është sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur.
- III. Numri i punonjësve është 60.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli



Lidhja nr. 2**ORGANIKA E DETAJUAR E ENTIT RREGULLATOR TË
TELEKOMUNIKACIONEVE**

KËSHILLI DREJTUES	Numri
Kryetar i Këshillit Drejtues	1
Anëtarë të Këshillit Drejtues	4
Sekretare e Këshillit Drejtues	1
 DREJTOR EKZEKUTIV (KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES)	
 KABINETI:	
Drejtor kabineti	1
Këshilltar ligjor	1
Sekretare e Drejtorit Ekzekutiv	1
 DREJTORIA JURIDIKE	
Drejtor drejtorie	1
 Saktori i Akteve Ligjore	
Përgjegjës sektori	1
Specialistë	2
 Zyra e Mosmarrëveshjeve	
Specialist	1
 DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK	
Drejtor drejtorie	1
 Saktori i Tarifave dhe Analizës së Kostos	
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1
 Saktori i Aksesit dhe Interkoneksionit	
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1
 Saktori i Studimit dhe Analizës së Tregut	
Përgjegjës sektori	1
Specialist	1
 Zyra e Shërbimit Universal dhe Mbrojtjes së Përdoruesve	
Specialist	1

DREJTORIA E RREGULLIMIT TEKNIK		
Drejtor drejtorie	1	
Sektori i Administrimit të Spektrit të Radiofrekuencave		
Përgjegjës sektori	1	
Specialistë	2	
Sektori i Planifikimit dhe Koordinimit të Spektrit të Radiofrekuencave		
Përgjegjës sektori	1	
Specialist	1	
Sektori i Numeracionit, Miratimit të Tipit dhe Treguesve të Cilësisë së Shërbimit		
Përgjegjës sektori	1	
Specialistë	2	
Sektori i Administrimit të Domain-it .al		
Përgjegjës sektori	1	
Specialistë	2	
DREJTORIA E LICENCIMIT		
Drejtor drejtorie	1	
Sektori i Operatorëve dhe Ofruesve të Shërbimeve Publike		
Përgjegjës sektori	1	
Specialistë	2	
Sektori i Operatorëve të Pavarur		
Përgjegjës sektori	1	
Specialist	1	
DREJTORIA E INSPEKTIMIT DHE MONITORIMIT TË SPEKTRIT		
Drejtor drejtorie	1	
Sektori i Monitorimit të Spektrit të Radiofrekuencave		
Përgjegjës sektori	1	
Specialistë	2	
Sektori i Inspektimit		
Përgjegjës sektori	1	
Specialistë	2	
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDASHME		
Drejtor drejtorie	1	
Sektori i Financës dhe Kontabilitetit		
Përgjegjës sektori	1	
Specialistë	2	
Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe i Shërbimeve Mbështetëse		
Përgjegjës sektori	1	

Specialist i Protokoll-Arkivës	1
Shoferë	3
Teknik mirëmbajtjeje	1
Nëpunës informacioni	1
Punonjës pastrimi	1

ZYRA E MARRËDHËNIEVE PUBLIKE DHE ME JASHTË

Specialist	1
------------	---

Gjithsej	60
----------	----

VENDIM Nr.98, datë 30.4.2007

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE


Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 10 pika 1 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", me propozimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Struktura e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
- II. Organika e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare është sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur.
- III. Numri i punonjësve është 58. Deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit për ndryshimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2007 numri i punonjësve është 37.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)**



ORGANIKA E AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

I. KRYETAR		1
KABINETI		(3)
KËSHILLTAR	2	1
SEKRETAR		
II. SEKRETARIATI I BORDIT		
SPECIALIST		1
III. AUDITIMI I BRENDSHËM		
INSPEKTOR		1
IV. DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES DHE DISIPLINIMIT	(18)	
NËNKRYETAR/DREJTOR I DEPARTAMENTIT		1
IV/1. DREJTORIA E RAPORTIMIT DHE ANALIZËS		(7)
DREJTOR		1
SEKTORI I RAPORTIMIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI		1
SPECIALISTË		2
SEKTORI I ANALIZËS E DISIPLINIMIT		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI		1
SPECIALISTË		2
IV/2.DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË RISKUT	(5)	
DREJTOR		1
SEKTORI I AKTUARISTIKËS	(3)	
PËRGJEGJËS SEKTORI		1
SPECIALISTË		2
SEKTORI I MODELIMEVE FINANCIARE		(1)
SPECIALIST		1
IV/3. DREJTORIA E INSPEKTIMIT	(5)	
DREJTOR		1
SEKTORI I SIGURIMEVE DHE PENSIONEVE		(3)
INSPEKTORË	3	
SEKTORI I LETRAVE ME VLERË		(1)
INSPEKTOR		1
V. DEPARTAMENTI I KËRKIMEVE, IT DHE STATISTIKËS	(8)	
DREJTOR		1
		1359

V/1. DREJTORIA E IT DREJTOR SPECIALIST	(2)	1 1
V/2. DREJTORIA E KËRKIMIT DHE STATISTIKËS DREJTOR	(5)	1
SEKTORI I KËRKIMIT DHE STATISTIKËS SPECIALISTË	(2)	2
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE ME PUBLIKUN PËRGJEGJËS SEKTORI SPECIALIST	(2)	1 1 1
VI. DEPARTAMENTI I LICENCIMIT DHE MONITORIMIT		(8)
NËNKRYETAR/DREJTOR I DEPARTAMENTIT		1
VI/1. DREJTORIA E LICENCIMIT DHE MONITORIMIT DREJTOR SEKTORI I LICENCIMIT SPECIALISTË SEKTORI I MONITORIMIT SPECIALIST	(4)	1 (2) 2 (1) 1
VI/2. DREJTORIA E RREGULLIMIT DHE STANDARDEVE DREJTOR SPECIALISTË	(3)	1 2
VII. DEPARTAMENTI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE DREJTOR VII/1 DREJTORIA JURIDIKE DREJTOR	(8)	1 (3) 1
SEKTORI I ÇËSHTJEVE LIGJORE SPECIALIST SEKTORI I HARTIMIT TË AKTEVE SPECIALIST	(1)	1 (1) 1
VII/2 DREJTORIA E ZBATUESHMËRISË DREJTOR SEKTORI I ZBATUESHMËRISË SPECIALISTË SEKTORI I MBROJTJES SË INVESTITORËVE SPECIALIST	(4)	1 (2) 2 (1) 1
VIII. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME DREJTOR SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIVËS SPECIALISTË SEKTORI I ADMINISTRIMIT FINANCIAR PËRGJEGJËS SEKTORI	(10)	1 (2) 2 (2) 1

SPECIALIST	1
SEKTORI I SHËRBIMEVE DHE PROKURIMEVE	(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	1
SHOFERË	3
PUNËTOR	1

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, pasi dëgjoi Raportin për Veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për vitin 2006, *konstaton* se:

Veprimtaria e Bankës së Shqipërisë është ushtruar në përputhje me kërkesat e nenit 161 të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Banka e Shqipërisë në veprimtarinë e saj i është përmbajtur objektivave të vendosur nga Kuvendi në rezolutën e fundit për vlerësimin e veprimtarisë së këtij institucioni. Gjatë veprimtarisë njëvjeçare të Bankës së Shqipërisë ekonomia shqiptare ka vazhduar rrugën e konsolidimit makroekonomik.

Prodhimi i përgjithshëm bruto i vendit vlerësohet të jetë rritur me 5 për qind në terma realë. Kjo rritje është shoqëruar me stabilitet çmimesh, të shprehur në një inflacion mesatar vjetor prej 2,5 për qind.

Kushtet monetare, të karakterizuara nga norma historikisht të ulëta interesi dhe qëndrueshmëri të kursit të këmbimit, kanë favorizuar rritjen e investimeve dhe të konsumit në ekonomi. Në mënyrë të veçantë, ato janë reflektuar në rritjen e shpejtë të kredisë me rreth 70 miliardë lekë.

Zhvillimet fiskale kanë rezultuar me tejkalim të ndjeshëm në mbledhjen e të ardhurave, duke kontribuar në konsolidimin e mëtejshëm të financave publike, kontrollin e deficitit buxhetor dhe rritjen e investimeve publike.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2006 në drejtim:

- të ruajtjes së stabilitetit ekonomik dhe financiar të vendit dhe ruajtjes së ritmeve të zhvillimit ekonomik, në përputhje me normat e parashikuara;

- të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve nëpërmjet mbajtjes së inflacionit në kufijtë vjetorë të planifikuar;

- të politikave monetare të ndjekura, të cilat kanë qenë të besueshme dhe fleksibël, duke iu përgjigjur zhvillimeve ekonomike e financiare të vendit. Ndërhyrjet në normën bazë të interesit dhe balancimi i kërkesës dhe ofertës për para kanë ndikuar në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe zbatimin e një regjimi të ri të politikës monetare për një periudhë afatmesme;

- të nxitjes së mëtejshme të kreditimit të ekonomisë së vendit, duke ruajtur stabilitetin dhe balancat makroekonomike e financiare të saj;

- të mbikëqyrjes efektive të rrjetit të sistemit bankar në Shqipëri, kontributit për zgjerimin e mëtejshëm të tij, përmirësimit të efektivitetit dhe rritjes së besueshmërisë së publikut ndaj sistemit bankar;

- të përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit bankar në Shqipëri, duke e përputhur atë me direktivat e BE-së, si dhe të nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të tij.

Kuvendi rekomandon që për vitin në vijim Banka e Shqipërisë t’u kushtojë vëmendje:

- Ruajtjes së stabilitetit makroekonomik të vendit dhe përmbushjes së objektivave për vitin 2007, të cilat rrjedhin nga marrëveshja midis Qeverisë Shqiptare, FMN-së dhe Bankës së Shqipërisë.

- Hartimit e zbatimit të politikave monetare afatmesme, me synim përshpejtimin e ritmeve të

zhvillimit ekonomik të vendit dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me BE-në.

- Dhënies së opinioneve dhe sugjerimeve për Qeverinë në lidhje me politikën monetare, si dhe hartimit të strategjive afatgjata dhe rajonale në sektorë të tillë si energjia, infrastruktura, tregtia, eksportet, investimet e huaja.

- Monitorimit të kujdesshëm të kreditimit të ekonomisë dhe nxitjes së përmirësimeve të strukturës së kredisë, duke synuar, në radhë të parë, veprimtaritë prodhuese e veçanërisht sektorin e bujqësisë.

- Kontributit në zgjerimin e mëtejshëm të sistemit bankar dhe shtrirjen e tij në gjithë zonat e vendit.

- Ndikimit në shtimin e shërbimeve që sistemi bankar u ofron qytetarëve dhe sektorëve privatë e publikë të ekonomisë.

- Ndikimit me politikat që harton dhe zbaton në reduktimin e informalitetit në ekonomi, si dhe zvogëlimin të transaksioneve me para në dorë.

- Luftës për parandalimin e përdorimit të sistemit bankar për pastrimin e parave të rrjedhura nga veprimtaritë kriminale dhe pasurive prej tij, në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian, si dhe objektivat për luftën ndaj terrorizmit.

- Monitorimit të shoqërive të kreditit dhe institucioneve jobankare, si dhe plotësimit të kuadrit ligjor për to.

- Vazhdimin të procesit të modernizimit të legjislacionit bankar në Shqipëri, me qëllim harmonizimin e tij me atë të BE-së.

Kuvendi shpreh bindjen se Banka e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2007 do të vazhdojë të jetë një institucion i përgjegjshëm në fushën e hartimit dhe zbatimit të politikave monetare dhe të konsolidimit të mëtejshëm të sistemit financiar të vendit.

3 maj 2007

DEKRET
Nr.5273, datë 27.4.2007

PËR LIRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika “dh” të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Sokol Gjoka lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Polonisë, rezident, si dhe e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Estonisë, Republikën e Lituanisë, Republikën e Letonisë dhe në Republikën e Ukrainës, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5274, datë 27.4.2007

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92 pika “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Florent Çeliku emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Polonisë, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Estonisë, Republikën e Lituaniës, Republikën e Letonisë dhe në Republikën e Ukrainës, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr.5285, datë 2.5.2007

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të nenit 20 dhe të nenit 9 pika 7 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”,

DEKRETOJ:

Neni 1

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij:

Ylber Bedri Hysa.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.212, datë 18.4.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.185, DATË 29.3.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LEJIMIN E NDËRMARRJES “MEICO” TË MINISTRISË SË
MBROJTJES, TË PËRDORË PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”, PËR
RIPARIMIN E HELIKOPTERËVE BO 105 M VBH, TË DHURUAR NGA MINISTRIA E
MBROJTJES E REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË DHE PËR SIGURIMIN E
PJESËVE TË KËMBIMIT PËR KËTA HELIKOPTERË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.185, datë 29.3.2006 të Këshillit të Ministrave, tabela “Pagesa e institucioneve, që do të kryhen për ndërmarrjen “Meico””, të zëvendësohet me tabelën me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGESAT E INSTITUCIONEVE QE DO TE KRYHEN PER NDERMARRJEN "MEICO"

Ne Milion leke

Nr.	Emertimi	Viti 2006						Viti 2007						Viti 2008						TOTALI		
		Vlera totale	Nga te cilat:		Afati i pageses	Vlera totale	Nga te cilat:		Afati i pageses	Vlera totale	Nga te cilat:		Afati i pageses	Vlera totale	Nga te cilat:		Afati i pageses	Vlera totale	Nga te cilat:		TOTALI	Nga te cilat
			Art.602	Art.231			Art.602	Art.231			Art.602	Art.231			Art.602	Art.231			Art.602	Art.231		
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15						
1	Ministria e Mbrojtjes	369.677	311.105	58.572	Brenda 10 diteve nga nenshkrimi i kontrates	468.274	430.693	37.581	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	144.386	119.852	24.534	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	982.337	861.650	120.687						
2	Ministria e Brendshme	86.341	78.691	7.650	Brenda 10 diteve nga nenshkrimi i kontrates	0.000	0.00	0.00	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	256.891	256.891	0.000	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	343.232	335.582	7.650						
3	Ministria e Shendetesise	1.428	1.428	0.000	Brenda 10 diteve nga nenshkrimi i kontrates	0.000	0.00	0.00	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	0.000	0.000	0.000	Brenda 30 diteve nga çelja e buxhetit te vitit	1.428	1.428	0.000						
	TOTALI	457.446	391.224	66.222		468.274	430.693	37.581		401.277	376.743	24.534		1326.997	1198.660	128.337						

VENDIM
Nr.213, datë 18.4.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.230, DATË 4.4.1998 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PRIVATIZIMIN E PJESËVE TË KAPITALIT TË ZOTËRUAR NGA SHTETI, NË SHOQËRITË ME KAPITAL TË PËRBASHKËT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.230, datë 4.4.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i dytë i pikës 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Ortaku shtetëror njofton ministrinë apo institucionin, qendror a vendor, nga i cili ka pasur varësinë ndërmarrja shtetërore në çastin e nënshkrimit të kontratës, për krijimin e shoqërisë me kapital të përbashkët, si dhe shoqërinë, për miratimin e privatizimit të pjesës shtetërore të kapitalit.”.

2. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Ortaku shtetëror thërret asamblenë e ortakëve për marrjen, nga ortaku joshtetëror, të miratimit të privatizimit të kuotave, të zotëruara nga shteti, si dhe propozon e zgjedh ekspertët përkatës, të cilët miratohen në asamble për vlerësimin e shoqërisë, për efekt të shitjes së pjesës shtetërore.”.

3. Paragrafi i dytë i pikës 4 shfuqizohet.

4. Paragrafi i dytë i pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Dokumentacioni i privatizimit, i përgatitur nga shoqëria, përcillet në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, e cila ia dërgon, më pas, Ministrisë së Financave.”.

5. Pika 19 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“19. Nga të ardhurat e shitjes së pjesëve të kapitalit të zotëruar nga shteti përfitojnë:

a) Ministria e Financave, 5 për qind;

b) Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, 5 për qind;

c) Buxheti i Shtetit, 90 për qind.

Kriteret e administrimit dhe të përdorimit të fondit, që përfiton Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

6. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.215, datë 18.4.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.704, DATË 11.10.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHET, SI DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

VENDOSI:

Në vendimin nr.704, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në kapitullin III “Procedura e shitjes së pronës shtetërore”, të bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “c” e paragrafit të dytë të pikës 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Ministria e Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, fillimisht, duhet të vendosë njoftim, me afishe, në mjediset, ku do të organizohet zhvillimi i ankandit të tyre, ndërsa dega e shoqërive publike, në prefekturë, vendos afishe në mjediset e veta dhe në ndërmarrjen, ku ndodhet objekti që privatizohet, sipas të dhënave (afisheet dërguar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike).

DSHP-ja dërgon zyrtarisht procesverbal për vendosjen e afisheve, brenda afatit të botimit në Drejtorinë e Administrimit dhe të Shitjes së Pronave Publike.

b) Në pikën 9, fjalët “... përveç sa kërkohet në pikën 7...” zëvendësohen me “...përveç sa kërkohet në pikën 8...”.

c) Në pikën 12, fjalët “...botimi bëhet sipas pikës 5...” zëvendësohen me “...botimi bëhet sipas pikës 6...”.

ç) Pika 18 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“18. Të ardhurat nga vlera e shitjes së objektit ndahen:

- 5 për qind e vlerës së shitjes, Ministrisë së Financave;

- 5 për qind e vlerës së shitjes, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

- 5 për qind e vlerës së shitjes, ministrisë së varësisë administrative të objektit. Për rastet kur institucioni i varësisë administrative të objektit nuk ekziston, sipas pikës 4 kapitulli IV të vendimit nr.704, datë 11.10.2006 të Këshillit të Ministrave, të ardhurat i kalojnë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

- 85 për qind e vlerës së shitjes, Buxhetit të Shtetit.”.

d) Pas pikës 20 shtohet pika 20/1, me këtë përmbajtje:

“20/1.a) Kontratat e nënshkruara nga përfaqësuesi i ish-Agjencisë Kombëtare të Privatizimit dhe i degëve të saj në rrethe, për objektet apo ndërmarrjet e privatizuara në vite, me përfaqësuesin e ndërmarrjes dhe blerësit, por jo sipas mënyrës së kërkuar nga ligji (para noterit), për rastet kur aktualisht nuk ekziston ndërmarrja, do të bëhen para noterit nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, dhe blerësi, kur dokumentacioni, që ndodhet në arkivat e kësaj drejtorie, është i rregullt.

b) Për rastet kur nga ish-Agjencia Kombëtare e Privatizimit dhe degët e saj në rrethe janë kryer të gjitha procedurat ligjore për privatizimin e objekteve apo të ndërmarrjeve shtetërore, sipas dokumentacionit të plotë, që ndodhet në arkivin e ish-AKP-së, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike (dosja e vlerësimit, ankandi apo e drejta e parablerjes, autorizimi për kalim pronësie, pagesa e plotë, dorëzimi etj.), por që, për arsye të ndryshme, nuk ka qenë e mundur të lidhet kontrata e shitjes dhe kur aktualisht nuk ekziston ndërmarrja, që e ka pasur në administrim objektin, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, kryetari i degës së shoqërive publike, në prefekturë, në juridiksionin e të cilit ndodhet objekti, dhe blerësi nënshkruajnë kontratën e shitjes, sipas legjislacionit në fuqi.”.

2. Në kapitullin IV “Detyrat dhe të drejtat për zbatimin e këtij vendimi”, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 4, fjalia “Respektimi i këtij afati kontrollohet nga organi përkatës i varësisë administrative” zëvendësohet “Respektimi i këtij afati kontrollohet nga dega e shoqërive publike përkatëse.”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Dokumentacioni i përgatitur nga komisioni i vlerësimit dërgohet për kontroll në degën e shoqërive publike përkatëse. Kur, pas kontrollit të degës së shoqërive publike, ky dokumentacion rezulton i rregullt, në përputhje me legjislacionin e privatizimit, ai i dërgohet, brenda 10 ditëve:

- Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe të Energjetikës, për objektet ndërtimore dhe linjat e prodhimit ose shërbimit;

- Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, për makineritë, pajisjet, mjetet e transportit, inventarin ekonomik e mjetet e xhiros etj.”.

c) Pika 6 shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.216, datë 18.4.2007

**PËR PROCEDURAT E KONKURRIMIT PUBLIK, PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTEVE
TË LICENCUARA, PËR RESTAURIMIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Rregulla të përgjithshme

1. Restaurimi i monumenteve të kulturës, me fonde të vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, bëhet edhe nga subjekte private, të licencuara, për këtë qëllim, nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, sipas dispozitave të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar.

2. Përzgjedhja e këtyre subjekteve private bëhet nëpërmjet konkurrimit publik të zhvilluar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe drejtoritë rajonale të monumenteve të kulturës, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Kulturës Popullore apo institucione të tjera shtetërore, të autorizuar, për këtë qëllim, nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

II. Procedurat e konkurrimit publik për restaurimin e monumenteve të kulturës

1. Drejtuesi i institucionit që disponon fondin buxhetor për restaurim, fillon procedurat e konkurrimit, me nxjerrjen e urdhrit të konkurrimit publik, i cili përmban:

a) Të dhënat e njoftimit, që do të botohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, për objektin, që do të restaurohet;

b) Fondin limit, të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, për këtë restaurim;

c) Përbërjen dhe emrat e anëtarëve të komisionit të konkurrimit;

ç) Llojin e objektit, monument kulture, që do të restaurohet;

d) Pasaportën e objektit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK);

dh) Kriteret e ndërhyrjes restauruese, sipas Kartës Shqiptare të Restaurimit;

e) Mënyrën dhe kohën e publikimit (kjo përcaktohet në pikën 2);

ë) Datën, orën dhe vendin e mbledhjes së komisionit, për hapjen dhe shqyrtimin e ofertave.

Komisioni i konkurrimit, sipas shkronjës “c” të kësaj pike, përbëhet nga kryetari dhe 7 (shtatë) anëtarë, 5 (pesë) specialistë të fushës, 1 (një) ekonomist dhe 1 (një) jurist.

Komisioni ndahet në dy pjesë, në njësinë e hartimit të dokumenteve të konkurrimit, me 3 (tre) anëtarë, përkatësisht juristin dhe 2 (dy) specialistë të fushës së restaurimit të monumenteve dhe në njësinë e vlerësimit, me kryetarin e 4 (katër) anëtarë, ekonomistin dhe 3 (tre) specialistë të fushës.

Juristi i komisionit ka për detyrë zbatimin e ligjit gjatë të gjithë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, mbajtjen e procesverbaleve të punës të komisionit të konkurrimit, të cilat nënshkruhen nga të gjithë anëtarët, administrimin e dosjes përkatëse, si dhe çdo komunikim me shkrim për procedurën e zhvilluar, deri në lidhjen e kontratës me fituesin. Pas këtij çasti përgjegjësia për zbatimin e kontratës është e drejtuesit të institucionit, i cili lidh edhe kontratën me subjektin fitues.

2. Publikimi i konkurrimit për objektet, që do të restaurohen, bëhet nga drejtuesi i institucionit, që zhvillon konkursin publik, dy herë në javë, në një organ të shtypit periodik, me tirazh kombëtar dhe në një media elektronike, si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, jo më vonë se 5 ditë nga dalja e urdhrat të konkurrimit publik.

3. Njoftimi për publikim duhet të përmbajë të dhënat përkatëse për:

- a) institucionin, që zhvillon konkursin publik;
- b) emërtimin dhe vendndodhjen e objektit, që do të restaurohet;
- c) fondin limit për këtë restaurim dhe burimin e tij;
- d) afatin e kryerjes së restaurimit;
- e) datën, orën dhe vendin e dorëzimit të ofertave;
- dh) dokumentacionin, që duhet të paraqesin subjektet private për konkurrim;
- e) datën, orën dhe vendin e mbledhjes së komisionit shqyrtues të ofertave.

4. Komisioni i ngarkuar për zhvillimin e procedurave të konkurrimit përgatit dhe vë në dispozicion të kandidatëve konkurrues dokumentacionin standard, që do t'u ofrohet subjekteve private, që do të shfaqin interes për pjesëmarrje në konkurs, i cili përmban:

a) Të dhëna të hollësishme për objektin monument kulture që do të restaurohet, emërtimin dhe vendndodhjen e tij, projektin e restaurimit, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit, ku përcaktohen nevojat e tij për ndërhyrje, të dhënat teknike, kriteret e ndërhyrjes dhe specifikimet teknike, sipas Kartës Shqiptare të Restaurimit të Monumenteve;

b) Një preventiv, me zërat e punimeve restauruese dhe të vëllimeve përkatëse, si dhe afatin dhe grafikon e kryerjes së punimeve restauruese;

c) Një listë të dokumenteve administrativo-ligjore të subjektit privat, të licencuar për pjesëmarrje në konkurs;

ç) Kriteret vlerësuese për përzgjedhjen e subjektit më të mirë konkurrues;

d) Formularin standard të ofertës së konkurrimit publik, i cili duhet të plotësohet nga subjekti konkurrues;

dh) Udhëzimet e nevojshme për kandidatët pjesëmarrës.

5. Dokumentacioni i subjekteve të interesuara për pjesëmarrje në konkurs, së bashku me ofertën ekonomike, dorëzohen në institucionin, që ka bërë publikimin, brenda afatit të publikuar në njoftimin publik dhe duhet të përmbajë:

a) Kërkesën e subjektit për pjesëmarrjen në konkurs;

b) Çmimin e ofruar për kryerjen e restaurimit, në zarf të mbyllur;

c) Dokumentacionin ligjor (vendim gjykate, statuti, akti i themelimit) të subjektit, që kërkon të kryejë restaurimin;

ç) Dokumentacionin fiskal të subjektit, që kërkon të restaurojë objektin (NIPT-in, certifikatën tatimore);

d) Vërtetimin nga prokuroria dhe gjykata, se subjekti nuk ka çështje, penale ose civile, që kanë lidhje me biznesin që ushtron;

dh) Vërtetimin nga dega e tatim-taksave, se subjekti ka shlyer, rregullisht, detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore.

6. Shqyrtimi i dokumentacionit të subjekteve konkurruese bëhet nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, në prani të konkurrentëve apo personave të autorizuar me shkrim, prej tyre. Afati i shqyrtimit dhe shpallja e subjektit fitues nga komisioni bëhet brenda 20 ditëve nga data e dorëzimit të ofertave.

7. Anëtarët e komisionit, në asnjë rast, nuk duhet të kenë konflikt interesi me pjesëmarrësit në konkurrimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9376, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" dhe për këtë ata deklarojnë, me shkrim, para zhvillimit të procedurave.

8. Procedura e konkurrimit publik zhvillohet kur në datën dhe orën e njoftimit publik paraqiten jo më pak se dy kandidatë ofertues.

a) Kur në datën dhe orën e shpallur nuk paraqitet asnjë konkurrent apo paraqitet vetëm një konkurrent ofertues, komisioni vendos refuzimin e ofertës së vetme dhe i propozon drejtuesit të institucionit përsëritjen e procedurës së konkurrimit, për mungesë konkurrence.

Në këtë rast procedura rifillon me përsëritjen e publikimit vetëm një herë në Buletinin e

Njoftimeve Publike dhe në mediat e përcaktuara në pikën 2 të këtij kreu.

Kur edhe gjatë procedurës së përsëritur nuk sigurohet konkurrenca dhe është paraqitur vetëm një konkurrent, komisioni i propozon Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve miratimin për vazhdimin e procedurës me një konkurrent.

b) Kur sigurohet konkurrenca, komisioni hap ofertat, i publikon ato dhe dokumentacionin shoqërues, të kërkuar, në prani të konkurrentëve, dhe më pas fillon shqyrtimin, brenda afatit të përcaktuar në pikën 6 të kreut II të këtij vendimi. Pas shqyrtimit, komisioni i konkurrimit shpall klasifikimin përfundimtar të ofertave të konkurrentëve dhe u bën të ditur të drejtën e ankimit, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të këtij klasifikimi, te drejtuesi i institucionit, që zhvillon procedurat e konkurrimit publik.

Pas këtij afati nuk pranohet asnjë ankim dhe komisioni i propozon drejtuesit të institucionit shpalljen e subjektit fitues dhe publikimin e tij, sipas pikës 9 të këtij kreu. Në të kundërt veprohet sipas procedurave, të përcaktuara në kreun III të këtij vendimi.

9. Njoftimi i subjektit fitues publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, ku përcaktohen:

a) Emri i fituesit dhe adresa e tij;

b) Afati i lidhjes së kontratës;

c) Sigurimi i kontratës, që fituesi duhet të bëjë për llogari të institucionit, si garanci për përmbushjen e detyrimeve kontraktore.

III. E drejta e ankimit administrativ

1. Çdo subjekt, pjesëmarrës në konkurs, ka të drejtën e ankimit administrativ të një veprimi ose mosveprimi nga institucioni, që ka zhvilluar procedurën e konkurrimit, të cilin subjekti pjesëmarrës e vlerëson shkelje të ligjit të trashëgimisë kulturore, të akteve nënligjore, në zbatim të tij, si dhe të këtij vendimi.

2. Paraqitja e ankesës te drejtuesi i institucionit, që ka zhvilluar konkursin, apo tek organi më i lartë i tij, përkatësisht, te Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, pezullon procedurat e konkurrimit publik, deri në dhënien e vendimit përfundimtar nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës deri në kthimin e përgjigjes, sipas kompetencave dhe afateve të përcaktuara në këtë vendim.

3. Pasi institucioni, që ka zhvilluar konkursin, të ketë nënshkruar kontratën me ofertuesin fitues, asnjë ankesë ndaj një veprimi ose mosveprimi në procedurën, që ka çuar në atë stad, nuk do të paraqitet për t'u shqyrtuar në rrugë administrative.

4. Ankesa me shkrim duhet t'i paraqitet drejtuesit të institucionit që ka zhvilluar konkursin, brenda 5 (pesë) ditësh pas datës së njoftimit të klasifikimit përfundimtar të ofertave të subjekteve pjesëmarrëse në konkurs.

5. Pas marrjes së ankimit, drejtuesi i institucionit pezullon procedimet e mëtejshme deri në shqyrtimin e tij dhe në marrjen e vendimit. Vendimi i njoftohet subjektit ankimues dhe konkurrentëve pjesëmarrës, brenda 10 ditësh nga data e depozitimit të ankimit.

6. Nëse drejtuesi i institucionit nuk lëshon një vendim brenda 10 ditëve ose subjekti ankues nuk është dakord me vendimin e drejtuesit të institucionit, subjekti ankues mund ta paraqesë ankesën pranë Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, brenda 5 (pesë) ditëve pas afatit për lëshimin e vendimit nga institucioni, që ka zhvilluar konkursin. Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është i detyruar të përgjigjet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas marrjes së ankesës.

7. Me përjashtim të rasteve kur ankesa nuk merret parasysh, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve mund të ndalojë institucionin, që ka zhvilluar konkursin, të veprojë ose të vendosë në mënyrë të jashtëligjshme dhe ta urdhërojë të procedojë në një mënyrë të drejtë, në përputhje me ligjin për trashëgiminë kulturore dhe legjislacionin në fuqi dhe/ose mund të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të jashtëligjshëm, të institucionit zhvillues të konkursit, përveç vendimit për të dhënë ose për të lidhur një kontratë.

Pas shqyrtimit të ankimit, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve mund të vendosë:

a) rrëzimin e ankimit dhe vazhdimin e procedurave nga institucioni zhvillues i konkurrimit publik;

b) pranimin e ankimit dhe revokimin e pjesshëm apo shfuqizimin e vendimit të dhënë nga drejtuesi i institucionit për ankimin e subjektit ankimues, si dhe rifillimin e procedurave nga çasti i konstatimit të veprimit apo mosveprimit të kundërligjshëm, në përputhje me ligjin për trashëgiminë kulturore dhe dispozitat e këtij vendimi;

c) sipas shkronjës “b” të kësaj pike dhe kur subjekti ankues ka ushtruar të drejtën e ankimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 8 të kreut II të këtij vendimi.

Vendimi i Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është përfundimtar dhe mund të ankimohet në organet gjyqësore brenda afatit të përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative.

IV. Kontrata e restaurimit

1. Lidhja dhe zbatimi i kontratës së sipërmarrjes së restaurimit të monumentit bëhet nga institucioni, që ka në dispozicion fondin dhe që ka zhvilluar konkurrimin, jo më vonë se 10 ditë nga data e shpalljes së fituesit në Buletin e Njoftimeve Publike.

2. Zbatimi i punimeve të restaurimit të objekteve, monument kulture, bëhet në përputhje me dispozitat e Kartës Shqiptare të Restaurimit të Monumenteve dhe me dispozitat e ligjit për trashëgiminë kulturore.

3. Në çdo rast, Instituti i Monumenteve të Kulturës autorizon specialistët për mbikëqyrjen e punimeve restauruese, deri në përfundimin e tyre, në përputhje me kushtet e parashikuara në kontratën e restaurimit.

4. Me përfundimin e restaurimit, pasaportës së objektit të restauruar i përditësohen të dhënat e restaurimit të kryer dhe regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

V. Dispozita të fundit

1. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe drejtoritë rajonale të monumenteve të kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrë udhëzim të veçantë për miratimin e dokumenteve standarde të konkurrimin.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.229, datë 25.4.2007

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE DHE TË MATERIALEVE TË USHTRISË TURKE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të personelit, të përbërë me 60 (gjashtëdhjetë) trupa ushtarake, 8 (tetë) civilë dhe 41 (dyzet e një) mjete ushtarake turke, në itinerarin Hani i Hotit-Durrës, në datat 30 prill-5 maj 2007.

Nga këto, 6 (gjashtë) trupa ushtarake do të rikthehen në Bosnjë-Hercegovinë, në itinerarin Durrës-Hani i Hotit.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë do të jetë pika e kalimit të kufirit, Hani i Hotit. Pika e daljes do të jetë pika e kalimit të kufirit, Durrës.

2. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të personelit, të përbërë me 6 (gjashtë) trupa ushtarake, 1 civil dhe 9 (nëntë) mjete të ushtrisë turke, në itinerarin Morinë-Durrës, në datat 1-4 maj 2007.

Nga këto, 3 (tri) trupa ushtarake do të rikthehen në Kosovë, në itinerarin Durrës-Morinë.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë do të jetë pika e kalimit të kufirit, Morinë. Pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit, Durrës.

3. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë

janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, dhe në marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

4. Trupat dhe mjetet turke, gjatë itinerarit të lëvizjes, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.231, datë 25.4.2007

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË DISA TRUPAVE USHTARAKE ITALIANE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, të 10 (dhjetë) trupave dhe 5 (pesë) mjeteve ushtarake italiane, në itinerarin Durrës-Qafë-Thanë, në datën 25 prill 2007.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të jetë pika e kalimit të kufirit, Durrës, dhe pika e daljes të jetë pika e kalimit të kufirit, Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951 dhe në marrëveshjen ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe në protokollin shtesë të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Gjatë itinerarit të lëvizjes, trupat italiane të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.233, datë 25.4.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS
NGA KTHESA E REPARTIT USHTARAK DERI TEK IMPIANTI I BOVILLËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës nga kthesa e repartit ushtarak deri tek impianti i Bovillës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ndërmarrjes së Ujësjiellës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen 12 488 m² tokë/arë, e vlerësuar me 700 lekë/m², në shumën e përgjithshme 1 741 600 (një milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 179 000 (njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë) lekë, të përballohen nga Ndërmarrja e Ujësjiellës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 1 741 600 (një milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind) lekë, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale, për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit maj 2007.

7. Ndërmarrja e Ujësjiellës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë, të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të përcaktuar në pikën 6, ndërsa për pronarët, për të cilët në kolonën e fundit të tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, paratë do të qëndrojnë të bllokuara në bankë deri në çastin, që pronarët të paraqesin dokumentacionin e pronësisë, pranë Ndërmarrjes së Ujësjiellës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ndërmarrja e Ujësjiellës-Kanalizimeve sh.a., Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË
RRUGËS NGA KTHESA E REPARTIT USHTARAK DERI NË IMPIANTIN E BOVILLËS**

Nr.	Emri	Sipërfaqja tokë/arë	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Shënime
1.	Astrit Hoxha	40 m ²	700	28 000	Plotësim dokumentacioni
2.	Hasan Livadhi	458 m ²	700	320 600	Plotësim dokumentacioni
3.	Skënder Livadhi	640 m ²	700	448 000	Plotësim dokumentacioni
4.	Gani Lozi	330 m ²	700	231 000	Plotësim dokumentacioni
5.	Gëzim Livadhi	1020 m ²	700	714 000	Plotësim dokumentacioni
	Shuma	2 488		1741600	

Vlera totale e këtij shpronësimi është 1 741 600 lekë (një milion e shtatëqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind) lekë.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR
3. REGJISTRAT E NOTERISË
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1.	PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006).....	1500
2.	PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
3.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
7	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
8	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 7.5.2007
Doli nga shtypi më 9.5.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 36 lekë